| AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR "OMNIA GROUP" shpk | ARTICLE OF INCORPORATION AND STATUTE OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY "OMNIA GROUP" LLC |
|---|---|
| Në këtë statut dhe akt themelimi:<br>- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";<br>- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë; | In this Statute and<br>– "Law" is the Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies"<br>– "Statute" is the Statute of the company |
| **Kreu I**<br>**Themelimi, Zoterimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia** | **Chapter I**<br>**Formation, Ownership, Object and Duration, Headquarter** |
| **Neni 1:**<br>**Data e Themelimit, Emri dhe Ortakët Themelues** | **Article 1**<br>**Date of Foundation, Name and Founders** |
| 1.1 Sot, më 21.11.2023 themeluesi, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "OMNIA GROUP" shpk. | 1.1 Today on 21.11.2023 the founder, has founded a limited liability company with the name "OMNIA GROUP" shpk. |
| 1.2 Themelues i shoqërisë është:<br>● Hamdi Picari, shtetas shqiptar identifikuar me numer personal K00304055W lindur më 04.03.2000 në Greqi, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar. | 1.2 The founder of the company is:<br>– Hamdi Picari, albanian citizen identified with personal number K00304055W, born on 04.03.2000, in Greece, major and with the full legal capacity. |
| **Neni 2**<br>**Objekti** | **Article 2**<br>**Object** |
| 2.1 Shoqëria do të kryeje aktivitetin e mëposhtëm:<br>Shërbime konsulence për menaxhimin e të drejtave të autorit dhe shitblerje në tregun muzikor.<br>Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. | 2.1 The company will carry out the activity as follows:<br>Consulting services for copyright management and sales in the music market.<br>The company can carry out any other business activity, which is not prohibited by the applicable law in the Republic of Albania. |
| **Neni 3**<br>**Kohëzgjatja** | **Article 3**<br>**Duration** |
| 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. | 3.1 The duration of the company will be without term limits. |
| **Neni 4**<br>**Selia**<br>4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën "Marqinet 2, Ndertesa Nr. 1, Hyrja nr.2, Vore, Tirane" | **Article 4**<br>**Legal Seat**<br>4.1 The legal seat of the company is at the address "Marqinet 2, Ndertesa Nr. 1, Hyrja nr.2, Vore, Tirane" |
| 4.2 Asambleja e ortakëve mund të hapi ose të mbylli | |

| | |
|---|---|
| adresa dytësore, filiale, zyra përfaqesimi ose degë, zyra në Shqipëri ose jashtë. | 4.2 The shareholders assembly may open and close secondary addresses, subsidiaries, representative offices or branches, offices in Albania or abroad. |
| **Kreu II**<br>**Kapitali** | **Chapter II**<br>**Capital** |
| **Neni 5**<br>**Kapitali themeltar** | **Article 5**<br>**Basic Capital** |
| 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë prej 1,000 (një mijë) lekë, i cili nuk është paguar. | 5.1 The initial basic capital of the company consists of 1(one) share with a value of 1,000 (one thousand) lekë, which is not paid. |
| 5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme: | 5.2 The participation of the founders in the basic capital of the company is in accordance with their contributions as follows: |
| • Hamdi Picari titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 1,000 (një mijë) lekë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë. | • Hamdi Picari owner of 1(one) share of value 1,000 (one thousand) lekë which constitutes 100% of company's capital. |
| **Neni 6**<br>**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit** | **Article 6**<br>**Increase and decrease of the Capital** |
| 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e përgjithshme e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. | 6.1 The capital of the company can be increased through the subscription of the parts of the basic capital for contribution in cash, and for the contribution in kind through the appointment from the competent court of an authorized expert for these contributions according to the requirements of the Administrator. |
| 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. | 6.2 The majority cannot obligate a shareholder to increase his contribution in the basic capital of the company. |
| 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila vendos në të njëjtat kushte që kërkohen për modifikimin e statutit. | 6.3 The decrease of the capital is allowed by the General Assembly, which will take the decision under the same conditions as for the amendment to the Statute. |
| 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi prek kapitalin e ortakëve në të njëjtën masë të pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë. | 6.4 In all case the decrease of the capital affects the shareholders to the same extent as their respective parts in the capital. |
| **Neni 7**<br>**Transferimi i kapitalit** | **Article 7**<br>**Transfer of Shares** |
| 7.1 Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre janë lirisht të transferueshme si në rastet më poshtë:<br>– në rastin e ortakut person fizik, per efekt të trashëgiminisë në rast vdekje apo nëse | 7.1 Shares of the company and the rights they confer shall be acquired or transfer through:<br>– in the case of a natural person, for the effect of inheritance in case of death or if they are transferred to the shareholder's spouse or descendants; |

transferohen të bashkeshorti apo pasardhësëve të ortakut;

- në rastin e ortakut person juridik nëse transferimi bëhet te ortakët e shoqërive pjesmarrëse (filialet) apo të lidhura me ortakun person juridik. Ky rast parashikon edhe mundësinë e operacioneve të mundshme të transformimit, bashkimit apo ndarjes apo blerjeve së shoqërive.

7.2 Në të gjitha rastet e tjera të transferimit të kuotave, i përket ortakëve e drejta e zgjedhjes dhe e preferencës.
7.3 Në cdo rast transferimi i kuotave te kapitalit nga ortaku duhet të bëhet me akt noterial.

**Kreu III**
**Organet e Shoqërisë**

**Neni 8**
**Organi Vendimmarrës**

8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për cështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) ndryshimet e statutit;
c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
e) përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
f) ekzaminimin e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitur nga administratorët;
g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera;
k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- in the case of a legal entity, if the transfer is made to the shareholders of participating companies (subsidiaries) or related to the legal entity shareholder. This case also foresees the possibility of possible operations of transformation, merger or division or acquisitions of companies.

7.2 In all other cases of shares transfer, the shareholders have the right of choice and preference.

7.3 In any case, the transfer of capital shares from the shareholder must be done by a notarial deed.

**Chapter III**
**Decision – Making Institutions**

**Article 8**
**Decision – Making Organ**
8.1 The General Assembly of Shareholders is the only decision-making organ of the company.
8.2 The General Assembly of Shareholders is the only decision-making organ of the company that approves any amendments to the Statute according to the modalities foreseen by the Law.
8.3 The General Assembly shall decide on the following company matters:

- Setting the business policies;
- Amendments to the Statute;
- Election and dismissal of the Administrators;
- Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
- Establishment of remunerations to persons mentioned under Numbers "c" and "ç";
- Monitoring and supervising the implementation of business policies by Managing Directors, including preparation of the annual statement of accounts and the performance report;
- Adoption of the annual statement of accounts and performance reports;
- Increase and reduction of basic capital;
- Dividing shares into parts and withdrawal of shares;
- Representation of the company in court and in other proceedings against Managing Directors;
- Company restructuring and dissolution;
- Adoption of its own rules of procedure;

| | |
|---|---|
| l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;<br>m) cështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti. | – Other matters set by law or the Statute. |
| 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. | 8.4 A shareholder may be represented at the General Assembly by another shareholder authorized by him or another third party.<br>Authorization can be given only for one meeting of the general assembly, which also includes subsequent meetings with the same agenda. |
| 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. | 8.5 The administrator of the company cannot act as a representative of the partners in the general assembly. |
| **Neni 9**<br>**Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme** | **Article 9**<br>**Method of Convening the General Assembly Meeting** |
| 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga Ligji, nga Statuti dhe cdo herë që asambleja bëhet e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. | 9.1 The general assembly is called in the cases provided by the Law, by the Statute and whenever the assembly becomes necessary to protect the interests of the company. |
| 9.2 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresën që rezulton nga Libri i Ortakëve ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike e certifikuar që u dërgohet të gjithe ortakëve. Njoftimi dërgohet të paktën 7(shtatë) ditë përpara datës së parashikuar per mbledhjen e Asamblesë. | 9.2 The general assembly is convened by means of a notice in writing to the address resulting from the Book of Partners or, by means of a notice through certified e-mail sent to all partners. The notification is sent at least 7 (seven) days before the scheduled date for the meeting of the Assembly. |
| 9.3 Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi tipin e asamblesë, vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës për thirrjen e parë dhe thirrjen e dytë. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë. | 9.3 The notice must contain information on the type of meeting, the place, date, time of the meeting and the agenda for the first and the second call. The Assembly can also be called outside the headquarters of the company. |
| 9.4 Asambleja do të thirret dhe do të mbahet rregullisht edhe kur nuk jane respektuar formalitet e njoftimit të saj, në momentin kur, janë prezent ortakët, të cilët përfaqësojnë kapitalin e plotë social. | 9.4 The Assembly will be convened and held regularly even when the formality of its notification has not been respected, at the moment when the partners, who represent the full social capital, are present. |
| 9.5 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamble edhe nëpërmjet telekonferencë ose nëpërmjet përdorimit të mjeteve të tjera elektronike me kusht që të jenë të identifikuar të gjithë të pjesëmarrësit dhe të jetë e mundur që të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë drejtëpërsëdrejti në trajtimin e rendit të ditës si dhe të kenë mundësi të shqyrtojnë apo të marrin | 9.5 Partners can also participate in the Assembly via teleconference or through the use of other electronic means provided that all participants are identified and it is possible to follow the discussion and participate directly in dealing with the agenda as well as having the opportunity to examine or receive the documentation and transmit it, and finally to |

dokumentacionin dhe ta transmetojnë atë dhe në fund te marrin rregullisht pjesë në votim dhe në vendimarrje.

**Neni 10**
**Kuorumi**

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë shumicën e kuotave të kapitalit.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për cështje që kanë të bëjnë me modifikimin e statutit, veprime që sjellin ndryshimin thelbësor te objektit të aktivitetit ose një ndryshim të rëndësishem të të drejtave të ortakëve, emërimin e likujduesve dhe kriteret e kryerjes së likujdimit, operacionet e transformimit, bashkimit apo ndarjes, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent personalisht ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e votave.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 11**
**Marrja e vendimeve**

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kuotave të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për cështje të tjera si:

a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
c) emërimin edhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

regularly participate in voting and decision-making.

**Article 10**
**Quorum**

10.1 In the case of taking decisions that require a simple majority, the general assembly can take valid decisions only if the shareholders with the right to vote who own the majority of the capital shares participate.

10.2 In the event that the general assembly has to decide on issues related to the modification of the statute, actions that bring about a fundamental change in the object of activity or an important change in the rights of shareholders, the appointment of liquidators and the criteria for carrying out the liquidation, operations of transformation, merger or division, the assembly can make valid decisions only if the shareholders holding more than half of the votes are present in the meeting.

10.3 If the general assembly cannot be convened due to the lack of quorum mentioned above, the assembly is convened again no later than 30 days, with the same agenda.

**Article 11**
**Decision-Making**

11.1 The General Assembly shall decide by three-quarter majority of votes of shareholders participating in the voting on the amendment to the Statute, the increase or decrease of the basic capital, profit distribution, company restructuring and dissolution

11.2 The general assembly decides with the majority of votes of the participating partners, on other issues such as:

- determining the commercial policies of the company;
- appointment and dismissal of administrators;
- appointment and dismissal of liquidators and authorized accounting experts;
- supervision of the implementation of commercial policies by administrators, including the preparation of annual financial statements and activity progress reports;

| | |
|---|---|
| e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;<br>f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; | – representing the company in court and in other proceedings against administrators;<br>– approval of the procedural rules of assembly meetings; |
| 11.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në ekstraktin e shoqërisë. | 11.3 Any amendment to the Statute must be submitted at the NBC in order to reflect the changes in the file of the company. |
| **Neni 12**<br>**Administrimi**<br>12.1 Administratorët kanë të drejtat dhe kompetencat për administrimin e përgjithshem dhe të vecantë të Shoqërisë brenda limiteve që vendos Ligji, ky Statut dhe kompetencat qe i përkasin asamblesë së ortakëve. | **Article 12**<br>**Administration**<br>12.1 Administrators have the rights and powers for the general and special administration of the Company within the limits set by the Law, this Statute and the powers that belong to the assembly of the shareholders. |
| **Neni 13**<br>**Kompetencat e Administratorëve**<br><br>Detyrimet e administratorëve:<br>a) Të kyejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;<br>b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;<br>c) Të kujdesen për mirëmbajtjen korrekte të dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqerise;<br>d) Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;<br>e) Të krijojnë një sistem kontrolli mbi rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;<br>f) Të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;<br>g) Të raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;<br>h) Të marr vendime të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e adresës/save te shoqërisë, duke përfshirë këtu dhe selinë qëndrore; | **Article 13**<br>**Rights and obligations of the Administrators**<br><br>The Administrator have the right and obligation to:<br>– Manage the company's business by implementing the policies defined by the General Assembly<br>– Represent the company;<br>– Ensure that the necessary accountancy books and documents are kept;<br>– Provide for and sign the annual statement of accounts and consolidated accounts and the performance report and present it to the General Assembly for approval together with the proposals for the distribution of profits;<br>– Create an early warning system with respect to developments threatening the existence of the company;<br>– File for the registrations and submit the mandatory data of the company according to the Law on the National Business Center;<br>– Report to the General Assembly with respect to the implementation of business policies and to the realization of transactions of particular importance for company performance;<br>– To take decisions related to the change of address/s of the company, including the headquarters; |

**Neni 14**
**Përgjegjësitë e Administratorit**

14.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje te kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
14.2 Dëmet e shoqërisë qe rrjedhin nga marrëveshjet të cilat nuk janë të miratuara nga asambleja i ngarkohen administratorit i cili ka bërë marrëveshjen;
14.3 Me përjashtim të rasteve të parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit te besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmëndje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
c) të vleresojë me përgjegjësi cështjet, për të cilat merret vëndim;
d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshem, të interesave personale me ata të shoqërisë;
e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

**Kreu IV**
**Viti financiar**

**Neni 15**
**Viti Financiar dhe bilanci vjetor**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

**Neni 16**
**Raporti vjetor**

16.1 Organi administrativ ose, sipas rastit, eksperti kontabël paraqet raportin financiar vjetor brenda 3(tre) muajve të vitit ushtrimor pasardhës.
16.2 Raporti përmban informacione mbi shpenzimet,

**Article 14**
**Responsibilities of the Administrator**

14.1 The Administrator is liable towards the Company or third parties for damages caused by breach of the laws, of the Statute, or for faults committed during the administration of the company.
14.2 The consequences for any unapproved agreement from the Assembly, that brings damages to the company, are charged on the Administrator and the Shareholder that has made the agreement to face individually or jointly as the case maybe the respective consequences.

14.3 Apart from what is provided in the general provisions on the fiduciary duty, according to articles 14, 15, 17 and 18 of the Law "On the Entrepreneurs and Commercial Companies, the administrator is oblige to:
a) perform his duties established by the law and the Statute in good faith in the best interests of the company as a whole which includes the environmental sustainability of its operations;
b) exercise powers granted to him by the law and the Statute only for the purposes established therein;
c) give adequate consideration to matters to be decided;
ç) avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the company;
d) perform his duties with professionalism and reasonable care.

**Chapter IV**
**Financial Year**

**Article 15**
**Financial Year**

The financial year commences on January $1^{st}$ and ends on December $31^{st}$, of each calendar year. Except for the first financial year, that commences from the date of registration of the company in the National Registration Center and is closed on December $31^{st.}$

**Article 16**
**Annual report**

16.1 The administrative body or, as the case may be, the accounting expert presents the annual financial report within 3 (three) months of the following fiscal year.

| | |
|---|---|
| të ardhurat dhe cdo lloj informacioni financiar tjetër mbi shoqërinë.<br>16.3 Asambleja miraton bilancin dhe llogaritë financiare të ushtrimit brenda 6 muajve të pare në vitin ushtrimor pasardhës.<br><br>**Kreu V**<br>**Prishja-riorganizimi i shoqërisë**<br><br>**Neni 17**<br>**Prishja dhe likuidimi**<br><br>Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te bëhet në cdo kohë me:<br>a) me vendim të Asamblesë së ortakëve;<br>b) me hapjen e procedurave të falimentimit;<br><br>**Neni 18**<br>**Riorganizmi i shoqërisë**<br><br>Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."<br><br>**Neni 19**<br>**Baza Ligjore**<br><br>Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.<br>Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe cilido ligj tjetër që aplikohet në Republikën e Shqipërisë.<br><br>**Neni 20**<br>**Mosmarrëveshjet**<br><br>Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe palës së tretë, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.<br><br>**Neni 21**<br>**Kopjet**<br><br>Ky Dokument u redaktua në 1(nje) kopje origjinale | 16.2 The report contains information on expenses, income and any other type of financial information on the company.<br>16.3 The Assembly approves the balance sheet and financial accounts of the exercise within the first 6 months of the following exercise year.<br><br>**Chapter V**<br>**Dissolution- Restructuring of the Company**<br><br>**Article 17**<br>**Dissolution and Liquidation**<br><br>The Company can be dissolved at any time, under the following circumstances:<br>– by decision of the General Assembly;<br>– by opening of the bankruptcy procedures;<br><br>**Article 18**<br>**Restructuring the company Merger- Division**<br><br>The company can be divided, merged based on the Decision of the General Assembly of the Shareholders according to the legal provisions foreseen in Part IX of the Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On the entrepreneurs and Commercial Companies"<br><br>**Article 19**<br>**Legal Basis**<br><br>The company will carry out its activity in conformity with this Statute and the legal provisions of the Albanian Legislation<br><br>Unless otherwise provided in this Statute, shall apply the provisions of the Law "On the entrepreneurs and Commercial Companies", Civil Code and any other specific law of the Republic of Albania<br><br>**Article 20**<br>**Disputes**<br><br>Any dispute arising out of or related with the implementation or interpretation of this Statute, as well as any dispute between the Company and third parties, shall be referred to the Albanian Court in Tirana District. |

në gjuhën shqip dhe anglisht.

Lexuar, miratuar, konfirmuar dhe nënshkruar nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**



Hamdi Picari

**Article 21**
**Copies**

This Document was edited in 1 (one) original copy in Albanian and English.

Read, understood, approved and signed by the founding shareholder.

**FOUNDING SHAREHOLDER**



Hamdi Picari